



BASHKIA HIMARE

Nr. 115 Prot.

Himarë më 17.12.2015

KONTRATE SHERBIMI

Për

Mbikqyrjen e punimeve në objektin

“Rehabilitimi i kalldreteve dhe fasadave të fshatit Kudhes”

E lidhur sot me datë 17.12.2015 ndërmjet **Bashkise Himare, (në cilësinë e investitorit)** përfaqësuar nga **Z.Jorgo Goro**, Kryetar, me adresë Spile, Himarë,

dhe

Kontraktorit **K&F Consulting shpk, (në cilësinë e sipërmarrësit)**, përfaqësuar nga **Z.Eduard Cepe**, Përfaqësues ligjor, me adresë: Lagja Nr.4, Rruga “Apostol Cuni”, Sarandë.

1. Baza Ligjore

Kjo Kontrate bazohet në Ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit (me të gjitha ndryshimet), me të gjitha ndryshimet, dhe VKM nr.3 datë 15.02.2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me të gjitha ndryshimet.

2. Objekti

Objekti i kësaj Kontrate është kryerja e mbikqyrjes së kontratës ***“Rehabilitimi i kalldreteve dhe fasadave të fshatit Kudhes”***, në vlerën **780.000** (shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Autoriteti Kontraktor ka pranuar ofertën e Kontraktorit për kryerjen dhe perfundimin e këtij shërbimi.

Mbikqyresit i punimeve merr persiper të drejtoje dhe të mbikqyre shërbimin në objektin e sipërpermendur sipas projektit dhe preventivit.

Shoqëria **K&F Consulting shpk** Sarandë, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L13928801L. Shoqëria e ka qendrën e saj në Sarandë dhe përfaqësohet nga Administratori i saj Z.Eduard Cepe, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar. Ajo është e pajisur me MK.2004/1, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 09.03.2015 dhe me afat vlefshmerie deri me datën 04.04.2021, leshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Kontrate mbikqyresi “Rehabilitimi i kalldreteve dhe fasadave të fshatit Kudhes”

3. Kohezgjatja e kontrates:

Zbatimi i kontrates fillon pas lidhjes se kontrates dhe eshte e vlefshme deri ne dorezimin e objektit.

4. Pagesa dhe Menyra e pageses:

Mbeshtetur ne VKM Nr. 704, datë 29.10.2014, "Mbi miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim", vlera e supervizimit te punimeve per "**Sherbimi i pastrimit dhe mirembajtje vorrezave Himare**" eshte:

780.000 (shtateqind e tetedhete mije) leke pa tvsh;

936.000 (nenteqind e tridhete e gjashte mije) me tvsh;

156.000 (njeqind e pesedhete e gjashte mije) tvsh.

Menyra e pageses do te jete: propocional me vleren e situacioneve te punimeve te kryera nga sipermarsi i punimeve e te miratuara nga mbikqyresi.

5. Vendi i ndertimit te vepres dhe mbikqyrja do te jete:

Fshati Kudhes i Bashkise Himare.

6. Komunikimi:

Komunikimi midis paleve kontraktuese do te jete i vlefshem vetem kur behet me shkrim.

7. Te drejtat dhe detyrimet e Mbikqyresit te punimeve:

Mbikqyresi i punimeve eshte i detyruar :

- a. Te kontrolloje mbarevajtjen e te gjithë procesit te zbatimit te punimeve, ne perputhje me projektin, kushtet teknike te projektimit, te zbatimit si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysh dhe anen ekonomike te tij.
- b. Te kontrolloje, librin e kantierit dhe eshte pergjegjes per saktesine vertetesine e dokumentave dhe cilesine e punimeve.
- c. Te beje verifikimet paraprake dhe hartimin e dokumentacionit perkates.
- d. Te miratoje materialet qe perdoren ne veper.
- e. Te marre pjese ne kolaudimin e vepres.
- f. Te percaktoje vleren perfundimtare ne lidhje me punimet.

8. Te drejtat dhe detyrimet e Bashkise Himare:

Bashkia Himare eshte e detyruar:

- a. T'i paraqese mbikqyresit te punimeve kontraten dhe aktet qe lidhen me te, projektin dhe preventivin e subjektit.
- b. Te largoje dhe zevendesoje mbikqyresin e punimeve kur vertetohen mangesi serioze ne veprimtarine e tij.

9. Penalitetet:

Kontrate mbikqyresi "Rehabilitimi i kalldreve dhe fasadave te fshatit Kudhes"

Mbikqyresi i punimeve duhet te kryej me seriozitet kontrollet dhe verifikimet e punimeve deri ne dorezimin e punimeve , pasi do te penalizohet ne masen 50 % te pageses se percaktuar ne kete kontrate apo propozim per heqjen e licences prane Organit Kompetent per dhenien e licencave, nese pas dorezimit te punimeve nga Ju dhe Kolaudatori, nga Grupi i marrjes ne dorezim te Autoritetit Kontraktor do te verifikohen difekte apo diferenca ne volume punimesh ne krahasim me librezet e masave te paraqitur.

10. Shuarja e mosmarrveshjeve:

Mosmarrveshjet eventuale qe mund te lindin gjate zbatimit apo interpretimit te kesaj kontrate, do te zgjidhen me mirekuptim dhe ne menyre te vullnetshme nga palet, ne rast te kundert, organi kompetent per zgjidhjen e mosmarrveshjeve do te jete Gjykata e rrethit Tirane.

11. Te tjera

Per sa nuk parashikohen ne kete kontrate, palet jane te detyruara te referohen ne dispozitat e ligjit nr.8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", me ndryshimet perkatese, dhe UKM nr.3 date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", me te gjitha ndryshimet, Kodit te Punes dhe Kodit Civil, me te gjitha ndryshimet.

Kjo kontrate hartohet ne tri kopje, dy prej te cilave i mban Autoriteti Kontraktor dhe nje Mbikqyresi i punimeve, siglohet ne çdo faqe dhe firmoset e vuloset ne faqen e fundit nga te dyja palet.

Bashkia Himare
Kryetari
Jorgo GORO



K&F CONSULTING shpk
Administratori
Eduard CEPE

